

PAKR.nr.447/2016

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Fillim Skoro, kryetar, Vahid Halili dhe Abdullah Ahmeti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi, si procesmbajtës, në çështjen penale të akuzuarit D.Xh., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK, të akuzuarit A.E., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK, të akuzuarit A.E. edhe për shkak të veprës tjetër penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK, të akuzuarit S.Sh., për shkak të veprës penale keqpërdorimi apo autoriteti zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK, të akuzuarit S.Sh., edhe për shkak të veprës tjetër penale, keqpërdorimi i pozitës apo autoriteti zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore-DKR në Gjilan, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Gjilan, PKR.nr.598/2013, të dt.21.06.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur në kuptim të nenit 390 të KPRK, me dt.27.12.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore-DKR në Gjilan, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Gjilan, PKR.598/13, i dt.21.06.2016, në pjesën liruese VËRTETOHET.

II. Në pjesën refuzuese aktgjykimi mbetet i pa prekur.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Gjilan P.nr.598/2013, të dt.21.06.2016, i akuzuari D.Xh., është liruar nga akuza për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo

autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK, i akuzuari A.E., është liruar nga akuza për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK,(vepra e dt.11.09.2009), i akuzuari A.E. është liruar nga akuza për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK, (vepra e dt.30.10.2009), ndaj të akuzuarve T.L., R.A. dhe M.H., është refuzuar akuza për veprën penale shpërdorimi i pozitës zyrtare ose autorizimit nga neni 339 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK, ndaj të akuzuarit S.Sh., është refuzuar akuza për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoriteti zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK, i akuzuari S.Sh., është liruar nga akuza për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoriteti zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK.

Është vendosur që shpenzimet e procedurës penale të bijnë në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor, ankesë ka paraqitur:

-Prokuroria Themelore-DKR Në Gjilan, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rigjykim.

-Përgjigje në ankesë të prokurorisë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit A.E., av.Fahredin Ymeri, me propozim që ankesa e prokurorit të shtetit të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokuroria e Apelit, me shkresën PPA/l.nr.414/2016, të dt.11.08.2016, ka propozuar që ankesa e PTH-DKR në Gjilan, të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rigjykim.

Gjykata në kuptim të nenit 390 të KPPK, mbajti seancën e kolegjit për të cilën nuk është njoftuar Prokurori i Apelit, të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre, meqenëse të akuzuarve nuk iu janë shqiptuar dënime me burgim, por si është thënë më lartë të njëjtit janë liruar nga akuza.

Gjykata shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, ankesën e Prokurorisë Themelore-DKR në Gjilan dhe përgjigjen në ankesë të mbrojtësit të akuzuarit A.E., av.Fahredin Ymeri dhe gjeti se:

Ankesa Prokurorisë është e pabazuar.

Pretendimet për shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjetjet e gjykatës.

Prokurori i shtetit në ankesë pretendon se aktgjykimin i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par.1.12 të KPPK, ngase aktgjykimi i ankimuar nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370 të KPPK, ngase dispozitivi është në kundërshtim me brendinë e tij, me arsyetimin si dhe faktet vendimtare dhe me përmbajtjen e provave materiale të administruara si në shkresat e lëndës, veçmas me ekspertizën financiare, prandaj si i tillë është i pa qëndrueshëm.

Pretendimet e prokurorisë se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, janë të pabazuara.

Së pari ankesa e prokurorisë është e mangët, sepse prokuroria në ankesë nuk thekson se ku qëndron kundërthënia e arsyetimit që ka dhënë gjykata e shkallës së parë, me përmbajtjen e provave materiale që i ka administruara gjykata e shkallës së parë.

Sipas gjetjes së kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar është hartuar ashtu si e detyrojnë dispozitat e nenit 370 të KPPK.

Dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar sipas kësaj gjykate nuk ka kundërthënie në brendinë e tij, sepse i njëjti edhe po të kishte kundërthënie të atillë e ka hartuar prokuroria, meqenëse dispozitivi i aktgjykimit është marrë nga dispozitivi i aktakuzës.

Në rastin konkret si u tha më lartë gjykata e shkallës së parë, ka pru aktgjykim lirues, prandaj, arsyetimi i aktgjykimit lirues nuk mund të jetë në harmoni me dispozitivin e aktgjykimit si pa të drejtë pretendon prokuroria.

Sipas gjetjes së kësaj gjykate arsyet që ka dhënë gjykata e shkallës së parë, në arsyetim të aktgjykimit nuk janë në kundërthënie me përmbajtjen e shkresave të lëndës, procesverbaleve si dhe me ekspertizën financiare të punuar nga eksperti financiar R.B.

Gjykata e shkallës së parë, aktgjykimin e ankimuar e ka hartuar ashtu si obligon dispozita e nenit 370 par.4,6 dhe 7 të KPPK, sepse në dispozitiv janë përfshirë të gjitha të dhënat e nevojshme të parapara në nenin 365 të KPRK.

Gjykata e shkallës së parë, në arsyetim të aktgjykimit ka paraqitur arsye për çdo pikë të aktgjykimit-për çdo provë të administruar, të cilat një nga një do të numërohen te gjendja faktike.

Gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të qartë dhe të plotë ka paraqitur arsye për faktet duke dhënë arsye se pse faktet i konsideron të pa vërtetuara.

Gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse në mes të provave tjera të administruara dhe ekspertizës së ekspertit financiar R.B., duke dhënë arsye me rastin e zgjidhjes së çështjes juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të mos ekzistimit të veprës penale të të akuzuarve.

Gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të veçanta pse në disa pjesë nuk i ka besuar ekspertizës së ekspertit financiar, duke konsideruar se interpretimi i dispozitave ligjore nuk është kompetencë e ekspertit financiar, por kompetencë ekskluzive e gjykatës, të cilin konstatim si të tillë e aprovon edhe kjo gjykatë.

Nga arsyet që u thanë më lartë, kjo gjykatë gjen se janë të pabazuara pretendimet e prokurorit të shtetit, se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Pretendimet për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe gjetjet e gjykatës.

Prokuroria në ankesë, në arsyetim të ankesës nuk ka ndarë bazat ankimore, por këtë gjykata e ka bërë sipas përmbajtjes së ankesës.

Prokuroria pretendon se si pasojë e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, ka ardhur deri te konstatimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike.

Gjykata e shkallës së parë, ka administruar provat edhe atë raportin e ekspertizës të bërë nga eksperti financiar R.B.j, vendimi për formimin e komisioneve të prokurimeve publike,

raportin vjetor për kontratat e nënshkuara publike, raportin e menaxhimit lidhur me rregullimin e trotuareve dhe kanalizimeve në fshatin Pozhoran, raportin e auditimit të pa varur të dt.31.12.2009, raportin e auditimit të dt.31.12.2010, dokumentacioni i hartuar nga "NN", raporti i menaxhimit brenda qendrës së Vitisë si dhe faturat që lidhen me te, vendimi mbi caktimin e S.Sh.t, menaxher për mbikëqyrjen e trotuareve dhe drunjëve dekorativ në Viti, raportin e komisionit për pranim teknik, në rregullimin e trotuareve dhe drunjëve dekorativ në Viti si dhe formimin e këtij komisioni.

Po ashtu nga mendimi i ekspertit financiar R.B., vërtetohet se marrëveshja gojore në mes të akuzuarit D.Xh. dhe F.H., për hartimin e projektit ideor si pretendohet nga i akuzuari i vënë në kundërshtim me dispozitivin e nenit 7,8,22,30 të Ligjit të Prokurimit Publik dhe në këtë mënyrë projektuesi F.H., ka përfituar pa respektua procedurën e tenderimit.

Eksperti R.B., edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në detale ka arsyetuar ekspertizën përkitazi edhe me shkeljet e bëra nga veprimet e të pandehurve A.E. e S.Sh., me detale të shprehura si në procesverbal.

Përkitazi me veprën penale në pikën II të dispozitivit, eksperti ka sqaruar se me rastin e vazhdimit të kontratës është vepruar në kundërshtim me nenin 34 të LPP, ku paraprakisht parashihet marrja e pëlqimit nga APP, për furnizim e që një detyrim i tillë ka qenë nga ana e të akuzuarit A.E.. Është i pa qëndrueshëm konstatimi i gjykatës së shkallës së parë se pëlqimi nga APP, nuk është vërtetuar a është paraparë shprehimisht që të merret në mënyrë obligative apo fakultative.

Dispozita në nenin 34 të LPP (kjo shkurtes përdoret për Ligjin për Prokurim Publik), është e qartë dhe në këtë drejtim kjo dispozitë është interpretuar gabimisht nga ana e gjykatës.

Përkitazi me veprimet e të akuzuarit S.Sh., gjykata me rastin e vendosjes për lirimin e të njëjtit nga akuza ka konstatuar në mënyrë të gabuar gjendjen faktike, se i akuzuari nuk ka guxuar të lejojë pagesën pa përfunduar punimet sipas projektit për rregullimin e trotuareve dhe kanalizimit, në fshatin Pozhoran, gjë që këto punime akoma nuk kanë përfunduar, që mbikëqyrës i këtij projekti ka qenë i akuzuari.

Konstatimi i gjykatës se pagesat janë bërë para përfundimit të punimeve nuk mund të konstatohet drejtpërsëdrejti se kush është përgjegjës vendimtar për lejimin e pagesave, është i pa qëndrueshëm sepse këtë e ka bërë i akuzuari S.Sh., duke iu referuar raportin hetues si dhe mendimit dhe konstatimit të ekspertit R.B.j.

Habit fakti se gjykata e shkallës së parë përkundër ekspertizës financiare ka marrë aktgjykim lirues.

Gjykata e shkallës së parë, ka bërë interpretimin e dispozitave të nënti 422 të KPRK. Në rastin konkret është situatë e qartë se në veprimet e të akuzuarit D.Xh., F.H., i është mundësuar përfitim i kundërligjshëm pasuror, me rastin e projektimit të rregullimit të trotuareve dhe drunjve dekorativ në Viti, pa respektuar procedurat e LPP, i njëjti ka përfituar 7.936,00Euro, nga operatori ekonomik NNP "Kristal", nga Vitia.

Po ashtu edhe sa i përket veprimeve të të akuzuarve A.E. dhe S.Sh., në mënyrë të qartë dhe bindur vërtetohet se kanë kaluar autorizimet dhe kompetencat përkitazi me detyrat e punës ku është shkaktuar dëm material si në dispozitiv të aktgjyimit të atakuar.

Është i pa qëndrueshëm qëndrimi i gjykatës në vlerësimin e mendimit të ekspertit financiar R.B.j, duke mos ia falë besimin se kinse i njëjti ka dalë jashtë kompetencave të tij ligjore, me rastin e hartimit të ekspertizës financiare.

Gjykata ka konstatuar se nga ekspertiza nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se fajësia e të akuzuarve për secilin veç e veç, nuk është vërtetuar se të njëjtit kanë ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të shkaktimit të dëmit personit tjetër apo organizatës tjetër duke mos analizuar detalet në vlerësimin e ekspertit.

Gjykata është dashur të analizoj deklaratat e dëshmitarëve N.A., F.R., S.B., J.R. dhe më pastaj të njëjtin secilin veç e veç ti vlerësoj me provat materiale dhe me mendimin e ekspertit financiar.

Habit fakti se gjykata e shkallës së parë duke i vlerësuar në mënyrë të gabuar secilën pikë të aktakuzës, në asnjë mënyrë nuk vlerëson drejt mendimin dhe konstatimin e ekspertit financiar, duke e justifikuar këtë veprim se me asnjë provë nuk mbështetet ekspertiza financiare, ky konstatim është i gabuar ngase ekspertiza bazohet në shkresa të lëndës.

Pretendimet e prokurorisë në ankesë se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të plotë nuk ka vërtetuar gjendjen faktike, atë që e ka vërtetuar është e gabuar, janë pretendimet të pabazuara.

Gjykata e shkallës së parë, ka administruar provat e propozuara, duke dëgjuar ekspertin financiar në shqyrtim gjyqësor, duke dëgjuar dëshmitarët F.H., J.R., Sh.S., S.B., F.R. dhe N.A., duke lexuar raportin e ekspertizës së ekspertit R.B. leximin e vendimit për formimin e komisioneve të prokurimeve publike, shikimin e ditarëve ndërtimor me nr.3/85, leximin e

raportit vjetor për kontratë të nënshkruar publike, leximi i raportit të menaxherit të projektit që lidhet me rregullimin e trotuareve dhe kanalizimit atmosferik në fshatin Pozhoran, leximi i raportit të auditori të pa varur të dt.31.10.2009, leximi i raportit të auditimit të dt.31.12.2010, dokumentacioni i përgjithshëm “NN”, raporti i menaxherit brenda qendrës së Vitisë si dhe faturat që ndërlidhen me këtë punë, leximi për caktimin e S.Sh.t, si menaxher për mbikëqyrjen e trotuareve dhe drunjëve dekorativ në Viti, leximi i raportit të komisionit për pranimin teknik në projektin për rregullimin e trotuareve dhe drunjëve dekorativ në Viti dhe vendimi për formimin e këtij komisioni, si dhe ka marrë në pyetje të akuzuarit D.Xh., A.E. dhe S.Sh..

Pas vlerësimit të provave të administruara gjykata e shkallës së parë, ka gjetur se nuk është vërtetuar se të akuzuarit D.Xh., A.E. dhe S.Sh., se me dashje me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete ose për personin tjetër, apo me qëllim të shkaktimit të dëmit, të kenë krye veprat penale keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK, në mënyrën, kohën dhe vendin e përshkruar si në dispozitivin nën I,II,III dhe VI të aktgjykimit të ankimuar.

Gjetjet e gjykatës së shkallës së parë, se nuk është provuar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar i aprovon edhe kjo gjykatë.

Sa i përket dëgjimit të dëshmitarëve dhe provat tjera të administruara që u theksuan më lartë një nga një, sikurse ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, edhe kjo gjykatë gjen se me asnjë provë të administruar nuk vërtetohet se të akuzuarit kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar.

Meqenëse prokuroria theksimin kryesor në ankesë e ka te ekspertiza e ekspertit financiar R.B.j, edhe kjo gjykatë do të jap konstatimet e ekspertit financiar R.B., si dhe gjetjet e kësaj gjykate rreth ekspertizës së ekspertit financiar R.B.

Eksperti financiar R.B., në ekspertizën me shkrim të dt.16.10.2012, në faqen 5, të ekspertizës ka dhënë mendimin dhe konstatimin se:

Për punën në projektin ideor-përfituese e të cilës është Kompania “NN”, nga Vitia nuk janë respektuar dispozitat e nenit 7,8,22 dhe 31 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës, nr.2003/2017.

Në faqen 8 të ekspertizës, eksperti financiar ka dhënë mendimin dhe konstatimin se procedurat e tenderimit për projektin e rregullimit të trotuareve dhe drunjëve dekorativ në Viti, në referim të tenderit të publikuar me numër prokurimi 657-09-022-521, mund të konkludohet

se janë respektuar me disa të meta të vogla, siç është p.sh. mungesa e pjesë së kontratës-kushte të veçanta.

Zëvendësimi i pllakave të betonit nga ato të trashësisë 4.00cm, me kupëza të betonit 8.00cm, është bërë në bazë të marrëveshjes verbale të përgjegjësve të komunës me punë kryesin si dhe me pëlqimin edhe të menaxherit, mbikëqyrësit të projektit.

Meqë kërkesa për punë shtesë ka qenë paraparë edhe diferenca e çmimit prej 3.0,00Euro/m², si rrjedhë zëvendësimi i pllakave të trashësisë 4cm, në 8cm, në vlerë prej 28.425,00, nuk është aprovuar nga apo APP, e që për rrjedhë si të tillë ka mbetur pa u realizuar, rezulton se buxheti i komunës mbi atë bazë nuk është dëmtuar.

Në faqen 10, eksperti financiar jep konstatim dhe mendim se:

Projekti për rrjedhën e kanalizimit në lagjen “Flaka e Janarit”, në Viti, është punuar nga ana e F.S., gjeodet nga Vitia, mbi bazën e marrëveshjes së arritur me D.Xh., në cilësi të përfaqësuesit zyrtar të Komunës së Vitisë. Vlera e projektit është caktuar në shumë prej 4.700,00Euro, e cila shumë në të gatshme është kompensuar nga mjetet e grumbulluara në komunitet. Kjo shumë është pranuar si participim i komunitetit me mirëkuptimin e donatorit kryesor nga Zvicra.

Nëse nuk është ndonjë gabim në deklarin e F.S., e deponuar në lëndë, theksohet se çmimi të jetë caktuar 1.20Euro për metër, rrjedh se për gjatësinë 1.100m, çmimi për projekt është 1,320.00Euro, nga rezulton një ndryshim prej 3,380.00Euro, mjete të paguara më tepër.

Eksperti financiar në faqen 11 të ekspertizës jep konstatimin dhe mendimin se:

Për furnizimin e komunës me derivatet e naftës për periudhën prej 07.09.2009, deri me dt.06.09.2010, nuk janë përfill procedurat e tenderimit si parashihet në nenin 30 të LPP, meqë ka qenë mundësia e vazhdimit të kontratës paraprake edhe për një vit, nuk është shfrytëzuar neni 34 me të cilin parashihet marrja e pëlqimit-autorizimit nga APP, për furnizim me përdorim të procedurave të negociuara pa publikim të kontratës, pra, me veprimet e theksuara nuk janë përfillur dispozitat e nenit 30 përkatësisht 34 të LPP.

Në faqen 13 të ekspertizës financiare, eksperti jep konstatimin dhe mendimin se:

Aneks kontrata e pasqyruar më sipër para se të nënshkruhet është dashur të kryhet procedura e paraparë në nenin 34 pika 2 e LPP, nga rrjedh se me rastin e nënshkrimit nuk janë respektuar dispozitat e LPP.

Në faqen 15 të ekspertizës, eksperti financiar jep konstatimin dhe mendimin se:

Aneks kontrata në shumë prej 7,925,00Euro e lidhur me dt.02.12.2010 është lidhur pa përfilljen e nenit 34 pika 2 të LPP, duke pasur parasysh faktin se nuk është bërë prerja e gjendjes së punëve të kryera dhe atyre të pa përfunduara, të paraparë me kontratën e punës nr.03-016/2020 dhe aneks kontrata nr.03-016/2622, në një anë dhe pagesat e bëra në anën tjetër në shumë prej 92,585.00Euro, rezulton se janë bërë pagesa më shumë se vlera e paraparë me kontratë bazë në shumë prej (89,538.00-92,585.00Euro=3.047,00Euro). Ndërsa në qoftëse merren parasysh vlera e kontratës bazë dhe aneks kontratës rezulton se autoriteti kontraktues Komuna po të ishin kryer të gjitha punimet do të ishte në detyrim ndaj operatorit në shumë (97,467.00-92,585.00Euro=me 4,878.00Euro).

Në faqen 16 eksperti financiar jep konstatimin dhe mendimin se:

Bardhok Jetishi, nuk ka pasur autorizim për të penguar zëvendësimin e pllakave përkundrazi edhe ky ka pasur bindje se zëvendësimi është i qëlluar. Buxheti i komunës nuk është dëmtuar mbi bazën e zëvendësimit me pllaka mbi kubëza betoni, nga kërkesa për ndryshmin e çmimit nuk është aprovuar, kështu që nuk është bërë kurrfarë pagese shtesë për atë qëllim.

I dyshuar S.Sh., nga shuma totale e paguar punë kryesit "Ballkan Project", prej 92,585.00Euro, ka lejuar pagesën në shumë prej 32,585.00Euro, ndërsa pjesën tjetër prej 60.000Euro, e ka lejuar pas ardhësi i tij.

Eksperti financiar R.B., në shqyrtim gjyqësor me dt.31.03.2016, ka theksuar se sa i përket tenderimit për projektin ideor të realizuar nga kompania "NN", i paraparë për rregullimin e trotuareve dhe drunjëve dekorativ në Viti, është konstatuar se nuk janë respektuar dispozitat e neneve 7,5,8,12 dhe 31 të LPP.

Për vet faktin se ka qenë obligim të zhvillohet procedura e tenderimit rrjedh se marrëveshja paraprake nuk është bërë konformë dispozitave të LPP.

Sa i përket dispozitivit nën II të aktakuzës, meqë është fjala për bazimin e kontratës nuk është shfrytëzuar nenin 34 i LPP, i cili parasheh marrjen e pëlqimit nga APP, për furnizim me përdorim të procedurave të negociuara pa publikim të kontratës. Një detyrim i tillë ka qenë i të akuzuarit A.E., që të merr pëlqimin nga APP për vazhdimin e kontratës.

Përkitazi me dispozitivin nën III të aktakuzës, neni 34 ka paraparë edhe punët shtesë nëse nuk tejkalojnë vlerën 10% të kontratës të autoriteteve kontraktuese ku në këtë rast ka qenë komuna. Komuna nuk ka konsultuar fare APP, është dashur të konsultohet.

Sa i përket pikës VI të aktakuzës, kontrata ka qenë e lidhur prej 92.585.00Euro, prej të cilës shumë menaxhmenti paraprak e ka lejuar pagesën prej 60.000Euro ndërsa Sabri Sherfiki, ka lejuar pagesën prej 32.585Euro dhe në kuadër të projektit për pjesën e fundit të punëve të kryera pa përfunduar në tersi punimet sipas projektit . një gjë e tillë nuk lejohet të bëhet para përfundimit të punëve dhe lidhur me këtë janë procedurat të cilat do të duhet të verifikohen, paraprakisht të bëhet verifikimi i punëve të punimeve në terren dhe pranimi i punëve të kryera e mbi këtë bazë, e në bazë të situacionit përfundimtar të përmbushjes së detyrimeve.

Unë nuk kam analizuar projektin ideor dhe nuk më kujtohet nëse kam pasur në posedim projektin ideor që ndërlidhet me pikën I të aktakuzës.

Nuk ka qenë detyrë e imja që të përcaktoj se është dëmtuar buxheti te tenderi që ka të bëjë me dispozitivin I të aktakuzës, por detyrë e imja ka qenë që të analizoj a është respektuar mënyra e tenderimit.

Me rastin e ekspertimit nuk është konstatuar se janë bërë tejkalime në kontest të pagesave të kryera për përfundimin e projektit të rregullimit të trotuareve dhe drunjëve dekorativ në Viti. Me vet faktin që nuk ka tejkalim atëherë do të thotë se nuk ka dëm të shkaktuar për Komunën e Vitisë.

Sipas nenit 34 të LPP është paraparë marrja e pëlqimit nga APP, me përdorim të procedurave të negociuara pa publikim të kontratave, nuk mund të përgjigjet decitivisht se a është paraparë pëlqimi të merret si obligativ apo fakultativ, e njëjta gjë vlen edhe për marrjen e pëlqimit për kryerjen e punëve shtesë në vlerë që nuk tejkalon 10%.

Është e vërtetë se kontrata paraprake ka qenë e nënshkruar nga menaxheri i prokurimit R.Sh., është paraparë edhe vazhdimi i kontratës për një vit e kjo i referohet dispozitivit nën II të aktakuzës.

Është lidhur aneks kontrata pa përfillur nenin 34 të LPP, nuk është bërë premje e gjendjes së punëve të kryera dhe atë të pa përfunduara të parapara me kontratë dhe aneks kontratë, nga rezulton se janë bërë pagesa më shumë sesa vlera e paraparë me kontratat bazë për shumën prej 3.047 Euro, ndërsa po qesë merret vlera e kontratës dhe aneks

kontratës dhe pagesave të bëra rrjedh se po të ishin kryer të gjitha punimet komuna autoriteti kontraktues do të ishte në detyrim ndaj operatorit ekonomik për shumën prej 4.378Euro, meqë bëhet fjalë për mos kryerjen e punimeve në tërësi, atëherë rrjedh se autoriteti kontraktues ka paguar më tepër për kryerjen e projektit se sa është bërë kryerja e punimeve.

Nuk mund të deklarojmë detajisht se shumën prej 7.925Euro ta kishte lejuar dikush tjetër e jo i akuzuari S.Sh..

Nuk jam i sigurt nëse S., ka lejuar më tepër se 24.660Euro.

Sa i përket dispozitivit nën II dhe III të aktakuzës nuk është konstatuar të ketë parë dëmtim në buxhetin e komunës së Vitisë.

Si ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, në aktgjykimin e ankimuar edhe kjo gjykatë gjen se për të ekzistuar veprat penale për të cilat janë akuzuar të akuzuarit D.Xh., A.E. dhe S.Sh., duhet që veprimet e kryerjes së veprave penale të ndermirën me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme për vete apo për personin tjetër, që do të thotë se pa ekzistimin e këtij qëllimi nuk mund të ketë as vepër penale. Me asnjë provë të administruar nuk vërtetohet fakti se D.Xh., A.E. dhe S.Sh., të kenë ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim që vetit apo organizatës së biznesit ti sjellin dobi pasurore të kundërligjshme apo ti shkaktojnë dëm.

Mos respektimi i ndonjë dispozite të LPP, nuk do të thotë se personi që nuk ka respektuar atë dispozitë ka hyrë në zonë kriminale, nëse nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim që vetit apo tjetrit ti sjellë dobi apo dëm.

Gjykata e shkallës së parë, me të drejtë ka konstatuar se për të akuzuarin D.Xh., nuk është vërtetuar qëllimi i tij, për të përfituar në mënyrë të kundërligjshme ai për vete apo për personin tjetër e as për ti shkaktuar dëm personit tjetër.

Në këtë drejtim është me rëndësi të theksohet konstatimi dhe mendimi i ekspertit financiar R.B., i cili konstatim dhe mendim u përshkrua edhe më lartë, i cili ekspert në shqyrtimin gjyqësor ka theksuar se gjatë ekspertimit nuk është konstatuar të jenë bërë tejkalime në kontest të pagesave të kryera për përfundimin e projektit për rregullimin e trotuareve dhe drunjëve dekorativ, me vet faktin që nuk ka pasur tejkalime nuk ka pasur as dëm të shkaktuar komunës së Vitisë. Për të akuzuarin D.Xh., përveç që nuk është vërtetuar se ka pasur për qëllim përfitimi apo dëmtimi në anën tjetër nuk i janë shkaktuar kurrfarë dëmi komunës së Vitisë.

Si gjykata e shkallës së parë, po ashtu edhe kjo gjykatë ekspertit financiar R.B., i ka falë besimin, sepse eksperti financiar angazhohet si profesionalist kur kemi të bëjmë me mjete financiare. Në këtë drejtim ekspertiza e ekspertit financiar është e bazuar edhe në prova tjera që gjenden në shkresat e lëndës.

Sa i përket projektit ideor duhet theksuar edhe deklaratën e dëshmitarit F.H., i cili ka theksuar se për projektin ideor nuk ka pasur procedurë të tenderimit, por vetëm marrëveshje, është vepruar njëjtë si në për të gjitha komuna e Kosovës, për shkak të mungesës së kodeve të veçanta për përpilimin e projekteve ideore në atë kohë.

Eksperti financiar R.B., në ekspertizën e tij më tepër është marrë me dispozita ligjore se sa me punën e tij si ekspert financiar, prandaj, edhe në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë, me të drejtë konstaton se nuk është punë e ekspertit financiar që të përcaktoj se cilat dispozita ligjore nuk janë respektuar ngase kjo është çështje ligjore dhe është kompetencë ekskluzive e gjykatës.

Si nga deklaratat e dëshmitarëve po ashtu edhe nga provat tjera të administruara nuk vërtetohet-provohet se të akuzuarit me dashje, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror, duke keqpërdorë detyrën zyrtare, kanë përfituar për vete apo i kanë mundësuar dikujt tjetër përfitim apo i kanë shkaktuar dëm.

Nga shkresat e lëndës rezulton se përfitues i tenderit për kryerjen e punimeve ishte një kompani tjetër dhe autoriteti kontraktues nuk ishte detyrim për pagimin e projektit ideor.

Nga ekspertiza e ekspertit financiar nuk vërtetohet fakti se A.E., në mënyrë të kundërligjshme ka vazhduar kontratën për punë me operatorin ekonomik NTP "NN2", nga Vitia, për furnizim me derivate të naftës sepse edhe nga ekspertiza e ekspertit financiar nuk rezulton se marrja e pëlqimit nga autoriteti i prokurimit publik ka qenë e detyrueshme.

Sa i përket të akuzuarit A.E., lidhur me konstatimin dhe mendimin e ekspertit financiar R.B., të cilat i referohet prokurori në ankesë. Si u tha më lartë marrja e pëlqimit nuk është vërtetuar se ka qenë detyrim, ndërsa me provat e administruara nuk është vërtetuar qëllimi i përfitimit të kundërligjshëm, aq më tepër ku në kontratë bazë është parashikuar mundësia e vazhdimit të kontratës në kushte të njëjta.

Në anën tjetër kontratat dhe aneks kontratat që u referohen dispozitiveve nën II dhe III të aktgjykimit të ankimuar nuk kanë qenë vetëm përgjegjësi e të akuzuarit A.E., por edhe e kryetarit të komunës së Vitisë, N.A..

Sa i përket të akuzuarit S.SH., si menaxher për mbikëqyrjen e punës vetë të trotuareve dhe kanalizimeve në fshatin Pozhoran, lejimin e pagesave para përfundimit të punimeve gjykata e shkallës së parë, nuk i ka falë besimin ekspertit financiar sepse me provat e administruara nuk është vërtetuar se nuk janë përfunduar punimet.

Eksperti financiar nuk ka dalë në vendin e ngjarjes. Në anën tjetër N.A., si dëshmitar ka deklaruar se rregullimi i trotuareve në fshatin Pozhoran, është përfunduar në tërësi në të dy anët e rrugës e që vërteton mbrojtjen e të akuzuarit S.Sh., se janë bërë punë më shumë sesa kanë qenë të parapara. Edhe për të akuzuarin S.Sh., nuk është vërtetuar se ka ndër marrë veprime që vetit apo tjetrit ti sjell përfitim të kundërligjshëm.

Nga ajo që u tha më lartë kjo gjykatë gjen se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike kur ka konstatuar se nuk është provuar se të akuzuarit D.Xh., A.E. dhe S.Sh., kanë kryer veprën penale për të cilat janë akuzuar, si është cekur në dispozitivin nën I,II,III dhe VI të aktgjykimit të ankimuar.

Duhet theksuar se në procedurën penale barra e të provuarit bie mbi paditësin-prokurorin, kështu që prokurori me provat e administruara duhet të provoj se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, e nuk është barrë e të akuzuarit që të provoj se është i pa fajshëm për veprën penale për të cilën është akuzuar.

Krejtësisht në fund sipas nenit 3 par.2 të KPPK, mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal, interpretohen në favor të pandehurit dhe të drejtave të tij, sipas KPPK dhe sipas Kushtetutës të Republikës së Kosovës, prandaj, edhe mbi këtë bazë të akuzuarit është dashur të lirohen nga akuza.

Nga çka u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 401 të KPPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.447/2016, të datës 27.12.2016

Procesmbajtësi,

Anëtarët e kolegjit:

Kryetari i Kolegjit,

Eroll Gashi

1.Vahid Halili

Fillim Skoro

2.Abdullah Ahmeti
